

## **Intervistë me Shefin e Misionit të OSBE-së në Shkup, ambasadorin Clemens Koja për Independent Balkan News Agency (IBNA)**

**Data: 01 prill 2019**

- **Si e vlerësoni ecurinë e zhvillimeve në Maqedoninë e Veriut pasi që vendi u përballë me sfida të mëdha siç ishte zgjidhja e kontestit të emrit ?**

Mendoj se është shumë pozitive që pas ndryshimit të Kushtetutës dhe ndryshimit të emrit, qeveria dhe parlamenti e rikthyen fokusin e tyre ndaj nismës për reformat thelbësore. Jam veçanërisht i inkurajuar që legjislacioni i nevojshëm ka përparim në fusha të rëndësishme si shërbimi i inteligjencës dhe reforma gjyqësore, ku kemi parë bashkëpunimin ndërmjet partive qeverisëse dhe opozitare. Është e rëndësishme që të vazhdohet me përparimin drejt arritjes së qëllimeve strategjike të vendit dhe zbatimin e reformave që janë në interes të të gjithë qytetarëve. Si Mision, do të vazhdojmë të mbështesim përgatitjen dhe zbatimin e reformave që do të ndihmojnë vendin për të përmbushur më mirë angazhimet e OSBE-së dhe për të përmirësuar jetën e qytetarëve në vend.

- **Tani vendi hyri në zgjedhjet presidenciale. Si e vlerësoni klimën parazgjedhore?**

Kam ndjekur procesin e përzgjedhjes së kandidatëve nga partitë kryesore politike, dhe kam pasur gjithashtu rastin t'i takoj disa prej tyre. Unë pres një fushatë të drejtë dhe konkurruese, ku të gjitha palët do të kenë rastin të paraqesin idetë dhe kualifikimet e tyre për postin më të lartë të vendit. Ne do të kishim dashur të shohim realizimin e përpjekjeve për reformimin e Kodit zgjedhor përpara këtyre zgjedhjeve, në përputhje me rekomandimet e OSBE / ODIHR-it nga vëzhgimet e zgjedhjeve të kaluara. Ne do të vazhdojmë të mbështesim përpjekjet për të reformuar Kodin zgjedhor edhe pas zgjedhjeve.

- **A do të jetë OSBE me kapacitet monitorues sikur në zgjedhjet e kaluara?**

Monitorimi i zgjedhjeve është detyrë e Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MVZ) të OSBE / ODIHR-it i cili mbërriti në Shkup muajin e kaluar, të udhëhequr nga Corien Jonker. Ata planifikojnë të vendosen në mbarë vendin gjatë fushatës dhe në ditën e votimit. Lexuesit tuaj mund të kenë parë deklaratat nga konferenca për shtyp e Shefes së Misionit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Jonker më 12 mars, në të cilën ajo dha detaje rreth përbërjes dhe mandatit të Misionit të saj.

- **Gjuha e urrejtjes vazhdon të jetë një dukuri që rishfaqet në cikle zgjedhore. Cila është porosia juaj në këtë drejtim?**

Keni shumë të drejtë. Të dhënat mbi krimin e urrejtjes, të mbledhura nga Komiteti i Helsinkit, me mbështetjen e Misionit tonë, tregojnë se numri i incidenteve rritet ndjeshëm para zgjedhjeve.

Gjuha e urrejtjes është një dukuri negative që paraqet kërcënim për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe pajtimit politik. Megjithëse vendi akoma nuk mbledh statistika

të detajuara për incidentet e urrejtjes, sipas të dhënave që ekzistojnë, mos-toleranca në baza etnike, politike dhe fetare paraqet sfidë të shumëfishtë për vendin. Kjo dëshmon se nevojiten më shumë iniciativa që synojnë adresimin e tendencave ekzistuese.

Ne kemi mbështetur një numër iniciativash për të luftuar gjuhën e urrejtjes dhe krimin e urrejtjes. Ato më të fundit përfshijnë një fushatë ndërgjegjësimi publik mbi gjuhën dhe krimet e urrejtjes lidhur me ngjarjet sportive, si dhe mbështetjen tonë për krijimin e Rrjetit për Luftën kundër Gjuhës së Urrejtjes në Media. Ne do të vazhdojmë të mbështesim organet e drejtësisë penale, gjyqësorin dhe aktorët e shoqërisë civile në luftën kundër gjuhës së urrejtjes dhe krimin të urrejtjes.

- **Qeveria është para një sprove të re me reformat sidomos ne sferën e drejtësisë dhe organeve te sigurisë. Cili do të jetë fokusi dhe mbështetja juaj në këtë proces?**

Gjatë dy viteve të fundit janë miratuar disa ligje të rëndësishme për reforma. Megjithatë, zbatimi dhe aplikimi jo i njëjtë i këtyre nismave mbetet një sfidë.

Misioni i OSBE-së në Shkup do të vazhdojë të mbështes autoritetet gjyqësore në zbatimin e qëllimeve dhe masave të parashikuara në Strategjinë për reforma gjyqësore. Ndihma jonë do të përqendrohet në hartimin e legjislacionit dhe këshillimin e politikave, veçanërisht kur bëhet fjalë për zbatimin praktik të standardeve legjislative. Ne gjithashtu do të ofrojmë trajnime për ngritjen e kapaciteteve të praktikuesve ligjorë, si dhe do të vazhdojmë të monitorojmë gjykimet me profil të lartë.

Gjithashtu, do të vazhdojmë punën tonë intensive me Ministrinë e Punëve të Brendshme për të mbështetur reformat strategjike që synojnë rritjen e profesionalizmit të shërbimit policor, përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet policisë dhe komuniteteve, si dhe luftën ndaj kërcënimeve trans-nacionale, përfshi krimin e organizuar.